VENDIM
Nr. 821, datë 18.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 911, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN "RSM", NË SHTABE TË NDRYSHME TË NATO-s, NË AFGANISTAN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Kabul dhe Herat, Afganistan, si më poshtë vijon:

Në Shtabin e *Resolute Support Mission* (RSM HQ), në operacionin RSM", në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;
- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC-*Capital*), në operacionin "RSM", Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 4 (katër) ushtarakë;
- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Operacioneve të Forcave Speciale të NATO-s (NSOCC-A), në operacionin "RSM", në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;
- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në (TAAC-*West*), në operacionin "RSM", në Herat, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 6 (gjashtë) ushtarakë;
- venddislokimi, Herat, Afganistan.".

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo kontingjent, do të jetë me sistem rotacioni çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik). Për postet *Crisis Establishment* (CE), që plotësohen nga oficerë me gradën "Kolonel", rotacioni të jetë 1 (një) vit.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama